




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/22 datë: 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 12, paragrafet 1, dhe 2, shkronja (d), nenin 17 shkronja (f) dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Neneve 4, 5 dhe 11 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 dhe në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 31.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT Npi – 01/364, Datë: 30.12.2014 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR THEMELIMIN E NDËRRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më 31.01.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për shfuqizimin e Vendimit, Npi – 01/364, Datë: 30.12.2014 për formimin e Komisionit Komunal për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/19 datë:29.01.2024, dhe Komitetit për Komunitete, Npi-01/29 datë: 29.01.2024.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi